



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 03

Datë: 21. 01. 2022. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Fazli Stollaj, Čemailj Kurtiši.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Valmira Selmani, ud. drejtoresh e ZRPP.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së.

2. Raport i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Çështje Ligjore:

Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimeve të anëtarëve të Kuvendeve Komunale në: Pejë dhe Podujevë.

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i projektit dhe agjendës për punëtorinë: Raport mbi implementimin e planit të punës së KQZ-së i vitit 2021, dhe hartimi i planit të punës së KQZ-se për vitin 2022.

Këshilli i Personelit:

- Shqyrtimi dhe miratimi Rekomandimit të Këshillit të Personelit për shpalljen konkursit për pozitën e Zëvendës Krye shefit Ekzekutiv në SKQZ-së dhe Drejtorit Ekzekutiv të Zyrës për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim.

3. Të ndryshme.

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi: E hapim mbledhjen e tretë, anëtarja Gordana është ende në pushim shëndetësorë. Florian Dushi ka dhënë dorëheqje, dhe ai nuk do të marrë pjesë. Po fillojmë, sipas rendit të ditës...

Miratohet.

4. Raport i Këshillave të KQZ-së

1.Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimeve të anëtarëve të Kuvendeve Komunale në: Pejë dhe Podujevë:

Sami Kurteshi: Ne, kemi mbajtur takimin. Ne në mbledhje kemi trajtuar këto çështje, e kemi dëgjuar edhe zyrën ligjore, pra njëzëri ne kemi miratuar këto zëvendësime pa përjashtim. Atëherë, pra ne individualisht i kemi shqyrtuar të gjitha arsyetimet, bazën ligjore dhe propozojmë zëvendësimet ...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Pejës, i dorëhequra Mirzet Gjolloviq, zëvendësohet nga Izet Kojiq nga subjekti politik “Bosnjacka Iniciativa Peq”. Kush është për...?

Miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Podujevës, i dorëhequri Fatri Zhitia, zëvendësohet nga Ardi Hasani nga subjekti politik Lëvizja “Vetëvendosje!”. Kush është për...?

Miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Prishtinës, i dorëhequri Krenar Xhaferi, zëvendësohet nga Ajet Brajshori nga subjekti politik LDK. Kush është për...?

Miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Prishtinës, i dorëhequri Donat Lushaku, zëvendësohet nga Amir Siminica nga subjekti politik LDK. Kush është për...?

Miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Dragashit, i dorëhequri Resul Fetahu, zëvendësohet nga Naser Myrtezani nga subjekti politik LDK. Kush është për...?

Miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Dragashit, i dorëhequri Qamil Kolloni, zëvendësohet nga Mehmet Spahiu nga subjekti politik LDK. Kush është për...?

Miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Obiliqit, i dorëhequri Fatmir Bërbatovci, zëvendësohet nga Fidan Ahmeti nga subjekti politik “Iniciativa Qytetare për Obiliqin”. Kush është për...?

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Obiliqit, e dorëhequra Lindita Memishi, zëvendësohet nga Florije Jashari nga subjekti “Iniciativa Qytetare për Obiliqin”. Kush është për...?

Miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Obiliqit, i dorëhequri Slobodan Jakovleviq, zëvendësohet nga Ratomir Kostiq, nga subjekti Serbska Lista. Kush është për...?

Miratohet...

Me 9 vota për janë miratuar të gjitha zëvendësimet. Vazhdojmë me agjendën...

2. Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i projektit dhe agjendës për punëtorinë: Raport mbi implementimin e planit të punës së KQZ-së i vitit 2021, dhe hartimi i planit të punës së KQZ-se për vitin 2022:

Arianit Elshani: Këshilli ka shqyrtuar rekomandimin lidhur me punëtorinë dhe agjendën e saj. Pra, kemi kërkuar që veq shqyrtimit, edhe reduktimin e ditëve. Por, kemi hequr edhe disa pika që, tani veq janë miratuar në KQZ. Pra, ne rekomandojmë dy ditë pune: nga 4 shkurti, deri më 6 shkurt. Po ashtu, lokacioni të jetë jashtë zonave urbane, kjo për shkak të fokusimit më të mirë dhe angazhimit.

Punëtorja, do të përfshijë analizën e proceseve që kishim në 2021. Ne, prandaj në fund, rekomandojmë aprovimin e agjendës...

Në diskutim, u dhanë përgjigje rreth buxhetit nga z. Ilir Gashi. Ai tha se, ka buxhet të mjaftueshëm... Lidhur me menaxhimin e punëtorisë, z. Sami Kurtoshi tha se, këto takime po organizohen shpejtë. Kjo, për shkak të përgatitjeve më koncize... Mendoj që, disa rekomandime, sidomos të organizatave ndërkombëtare, nuk janë të përfshira... Ai, kërkoi që edhe lidhur me reformën, të mendohet në KQZ dhe të diskutohet, qoftë edhe përmes një punëtorie tjetër dhe, këto të përfshihen në planin e punës... Ilir Gashi, tha se, pajtohem me këtë propozim, dhe se këto çështje vërtetë duhet të shqyrtohen nga KQZ...

Kreshnik Radoniqi, tha se lidhur me ndryshimet ligjore të zgjedhjeve, ne duhet të jemi aktivë dhe, kjo buron edhe nga mësimet e nxëna. Arianit Elshani, tha se, lidhur me planin e punës jemi duke u fokusuar rreth punëtorisë, por pajtohem tha ai që “rekomandimet” tona lidhur me reformën zgjedhore, të jemi sa më aktiv. Madje, këto çështje t’i përfshijmë edhe në plan të punës: të jemi gati...

Kreshnik Gashi: Kush është për...?

Miratohet

3. Këshilli i Personelit:

Shqyrtimi dhe miratimi Rekomandimit të Këshillit të Personelit për shpalljen konkursit për pozitat e Zëvendës Kryeshefit Ekzekutiv në SKQZ-së dhe Drejtorit Ekzekutiv të Zyrës për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim:

Alim Rama, tha se këshilli ka shqyrtuar shpalljen e konkurseve. Po ashtu, mbas mbledhjes kemi pranuar edhe kërkesën e Ambasadës Britanike. E keni përmbajtjen. Prandaj, ne rekomandojmë që këto konkurse janë gati, dhe KQZ mund t'i shpallë këto konkurse. E keni materialin...

Në këtë pikë, diskutuan: Sami Kurteshi, i cili foli lidhur me aspektet teknike të realizimit të konkursit, afatin e tij, pranimin e aplikimeve të kandidatëve etj. Po ashtu, diskutuan edhe Ilir Gashi, Vahide Behrami nga Personeli, Kreshnik Radoniqi, Arianit Elshani, Burim Ahmetaj, Ibrahim Selmanaj, Alim Rama,

Të gjitha diskutimet, kishin të bënin me aspektet ligjore, procedurat, organizimin dhe implementimin e konkursit, afatet kohore etj.

5. Të ndryshme!

Për KQZ

Kreshnik Radoniqi, kryetar
